

PËRMBLEDHJE E NJË UDHËZUESI PËR
UDHËHEQËS LIDHUR ME MIRËQENIEN

PLOTËSIM I NEVOJAVE NË MËNYRËN E ZOTIT





*O*bjektivi real afatgjatë i Planit të Mirëqenies është formimi i karakterit tek anëtarët e Kishës, tek dhënësit dhe marrësit, shpëtimi i gjithçkaje më të mirë që është thellë brenda tyre dhe çelja e luleve dhe e frutave të pasurisë së fshehur të shpirtit, që, në fund të fundit, është misioni, qëllimi dhe arsyeja pse jemi në këtë Kishë.

J. Reuben Clark Jr., mbledhje e veçantë e presidentëve të kunjeve, 2 tetor 1936

PLOTËSIM I NEVOJAVE NË MËNYRËN E ZOTIT

Qëllimi i mirëqenies së Kishës është të ndihmohen anëtarët që të bëhen të vetëmbështetur, të kujdesen për të varfrit e nevojtarët dhe t'u shërbejnë të tjerëve.

Përmbajtja

Përgjegjësitë e Anëtarëve	1
Përgjegjësitë e Presidentit të Kunjit	4
Përgjegjësitë e Peshkopit	4
Parimet Bazë të Mirëqenies për Dhënie të Ndhmës	5
Burime të Kishës të Mundshme për të Ndhmuar të Varfrit	5
Burime Jo të Kishës të Mundshme për të Ndhmuar të Varfrit	8



Marku 12:41-44

PËRGJEGJËSITË E ANËTARËVE

Udhëheqësit e priftërisë dhe të Shoqatës së Ndihmës duhet t'i ndihmojnë anëtarët të kuptojnë përgjegjësitë që kanë për veten, për familjet e tyre dhe të tjerët.

PLOTËSIMI I NEVOJAVE VETJAKE DHE FAMILJARE

Anëtarët e Kishës janë përgjegjës për mbarëvajtjen e tyre shpirtërore dhe materiale. Të bekuar me dhuratën e lirisë së zgjedhjes ata kanë privilegjin e marrjes së vendimeve vetjake, duke zgjidhur problemet e veta dhe duke u përpjekur të bëhen të vetëmbështetur. Anëtarët e bëjnë këtë gjë nën frymëzimin e Zotit dhe me punën e duarve të tyre.

ELEMENTET E VETËMBËSHTETJES


Vetëmbështetje është aftësia, zotimi dhe përpjekja për të

plotësuar nevojat e jetës për vete dhe për familjen. Kur anëtarët bëhen të vetëmbështetur, janë gjithashtu më të mirë për t'u shërbyer dhe për kujdesur për të tjerët.

Kur anëtarët e Kishës po bëjnë gjithçka që ata mundën për të plotësuar nevojat e veta, por ende nuk u përgjigjen dot kërkesave të tyre bazë, ata duhet që, së pari, t'iu drejtohen për ndihmë familjeve të tyre. Kur kjo nuk u mjafton, Kisha qëndron e gatshme të ndihmojë.

Disa nga sferat në të cilat anëtarët duhet të bëhen të vetëmbështetur, përvijohen më poshtë dhe në faqen 2.

Arsimimi. Arsimimi mund të pasurojë, të fisnikërojë e të sigurojë kuptimin që të çon drejt një jete më të lumtur. Anëtarët duhet të studiojnë shkrimet e shenjta



dhe libra të tjerë të mirë; të përmirësojnë zotësinë në të shkruar, në të lexuar dhe në kryerjen e veprimeve matematikore bazë; dhe të fitojnë aftësitë e kërkuara për një punësim të përshtatshëm.

Shëndeti. Zoti i ka urdhëruar anëtarët që të kujdesen për mendjen dhe trupin e tyre. Ata duhet t'i binden Fjalës së Urtësisë, të hanë artikuj të ushqyeshëm, të bëjnë rregullisht ushtrime dhe të bëjnë gjumë të mjaftueshëm. Duhet t'u qëndrojnë larg substancave ose praktikave që abuzojnë me trupin ose mendjen e tyre dhe që mund të çojnë në varësi. Duhet të praktikojnë masa sanitare dhe higjienë të mirë dhe të sigurojnë një përkujdesje të përshtatshme mjekësore dhe dentare. Duhet edhe të përpiqen të kultivojnë marrëdhënie të mira me pjesëtarët e familjes dhe të tjerët.

Punësimi. Puna është themeli mbi të cilin qëndrojnë vetëmbështetja dhe mbarëvajtja materiale. Anëtarët duhet të përgatiten dhe të zgjedhin me kujdes një profesion ose një vetëpunësim të përshtatshëm që do t'u plotësojë nevojat vetjake dhe të familjeve të tyre. Duhet të aftësohen në punë, të jenë të zellshëm e të besueshëm dhe të kryejnë punë të ndershme për pagën dhe përfitimet që marrin.

Rezerva Shtëpiake. Që të ndihmojnë në përkujdesjen për

vete dhe familjen e tyre, anëtarët duhet që:

- Të krijojnë një rezervë ushqimore tremujore që është pjesë e ushqimit të tyre normal.
- Të rezervojnë ujë për rastin kur furnizimi me ujë ndotet ose çrregullohet.
- Të krijojnë ca nga ca një rezervë ushqimore më afatgjatë e cila do të mbështeste një konsum jetik.

Shih *All Is Safely Gathered In: Family Home Storage*, f. 3 (nr. i artikullit 04008).

Burimet Monetare. Që të vetëmbështeten financiarisht, anëtarët duhet që:

- Të paguajnë të dhjetat dhe ofertat.
- Të shmangin borxhin e panevojshëm.
- Të hartojnë një buxhet dhe të jetojnë brenda një planifikimi.
- Të krijojnë ca nga ca një rezervë monetare duke kursyer nga pak rregullisht.
- T'u mësojnë pjesëtarëve të familjes parime të administrimit monetar.

Shih *All Is Safely Gathered In: Family Finances*, f. 3 (nr. i artikullit 04007).

Forca Shpirtërore. Përshpirtshmëria është element i domoshëm për mirëqenien materiale

dhe atë të përjetshme të një njeriu. Anëtarët e Kishës duhet të ushtrojnë besim tek Ati Qie-llor dhe Jezu Krishti, t'u binden urdhërimeve të Perëndisë, të lutën përditë, të studiojnë shkri- met e shenjta dhe mësimet e pro- fetëve të ditëve të mëvonshme, të frekuentojnë mbledhjet e Kishës dhe të shërbejnë në thirrjet dhe detyrat e saj.

VËMENDJA PËR TË TJERËT

Gjatë shërbesës së Tij tokësore Shpëtimtari shkonte mes të var- fërve, të sëmurëve dhe të pikëllu- arve, duke u shërbyer nevojave të tyre e duke i bekuar ata me shërimin dhe shpresën. Ai i mësoi dishepujt të Tij të bënin të njëjtën gjë. Vajtja pranë atyre që janë të pikëlluar, është një tipar dallues kryesor i dishepujve të Jezu Krishtit (shih Gjoni 13:35).

Në kohët tona Zoti i ka urdhë- ruar sërish njerëzit e Tij të kujde- sen për të varfrit dhe nevojtarët. Ai tha: “Vini re, unë ju them se ju duhet të vizitoni të varfrit e nevojtarët dhe të administroni në ndihmë të tyre” (DeB 44:6). Anëtarët e Kishës janë të nxitur të bëjnë për nevojtarët shërbim vetjak zemërdhëmsur. Ata duhet të “përfshihen me zell në një kauzë të mirë”, duke shërbyer pa

iu kërkuar ose caktuar (shih DeB 58:26–27).

Zoti e ka cilësuar mënyrën e Tij të përkujdesjes për të varfrit dhe nevojtarët. Ai udhëzoi shenjtorët të “jepni nga pasuria juaj të var- fërve, . . . dhe [ajo] do të [vendoset] përpara peshkopit . . . [dhe] duhet të mbahet në shtëpinë time të ruajtjes, për t’iu administruar të varfërve dhe nevojtarëve” (DeB 42:31, 34).

Më tej Zoti shpjegoi se këto oferta duhej të përfshinin edhe talentet e anëtarëve. Këto talente duhen “hedhur në shtëpinë e ruajtjes së Zotit, . . . cilido duke kërkuar interesin e të afërmit të tij dhe duke bërë gjithçka me syrin drejtuar te lavdia e Perëndisë” (DeB 82:18–19).

Shtëpia e ruajtjes (depoja) e Zotit nuk kufizohet në një godinë që përdoret për të shpërndarë ushqim për të varfrit. Ajo përfshin ofertat besimplote të kohës, të talenteve, të dhembshurisë, të materialeve dhe të mjeteve monetare të anëtarëve besnikë, që i jepen peshkopit për t’u kujde- sur për të varfrit dhe nevojtarët. Depoja e Zotit, pra, ekziston në çdo lagje. Peshkopi është admini- stratori i depos së Zotit.

PËRGJEGJËSITË E PRESIDEN- NTIT TË KUNJIT

Presidencia e kunjtit sigurohet që peshkopët të kuptojnë parimet e mirëqenies dhe të zbatojnë mandatin e tyre hyjnor të kërkimit të zellshëm e përkujdesjes për të varfrit. Presidenti i kunjtit këshillohet me peshkopët dhe shqyrton dhurimet dhe shpenzimet e ofertave të agjërimit.

Presidencia e kunjtit mund të caktohet t'u japë udhëheqje priftërore veprimeve të mirëqenies si, p.sh., një depoje të peshkopëve ose një qendër të burimeve të punësimit.

Presidentët e kunjjeve frekuentojnë mbledhje të këshillave bashkërenduese për të marrë udhëzime në çështje të ndryshme të Kishës, përfshirë parime dhe

detyra mbi mirëqenien. Në këto mbledhje udhëheqësit shqyrtojnë mënyra për kultivimin e vetëmbështetjes, të kujdesit për nevojtarët dhe nxitjen e dhurimit të ofertave të agjërimit.

Presidentët e kunjjeve bashkërendojnë gjithashtu përpjekjet shumëkunjëshe për mirëqenien dhe reagimin në nevoja të ngutshme.

PËRGJEGJËSITË E PESHKOPIT

Peshkopi ka mandat hyjnor t'i kërkojë me zell e të përkujdeset për të varfrit (shih DeB 84:112). Ai drejton punën e mirëqenies në degë. Synimi i tij është të ndihmojë anëtarët që të ndihmojnë vetveten e të bëhen të vetëmbështetur. (Për degët, presidenti i degës ka po të njëjtat përgjegjësi për mirëqenien.)



Peshkopi takohet me anëtarë nevojtarë dhe shqyrton mënyra sa më të mira për të dhënë ndihmë e për t'i ndihmuar që ata të vetëndihmohen.

Peshkopët bekohen me dhuratën e dallimit që të kuptojnë si t'i ndihmojnë më së miri ata që ndodhen nevojtarë. Çdo rrethanë më vete është e ndryshme dhe kërkon një frymëzim. I udhëhequr nga Shpirti dhe nga parimet bazë të mirëqenies të këtij seksioni, peshkopi përcakton se kush të ndihmohet, sa të jepet dhe për sa kohë të ndihmohet.

Në përgjithësi një peshkop ndihmon vetëm ata anëtarë të cilët tashmë jetojnë brenda kufijve të lagjes së tij. Në raste të rralla peshkopi, nën frymëzimin e Shpirtit, mund të ndihmojë persona që nuk janë anëtarë të Kishës.

Peshkopi i mban të fshehta nevojat e mirëqenies së anëtarëve. Ai u tregon vetëm të dhëna të nevojshme udhëheqësve të priftërisë,, udhëheqësve të Shoqatës së Ndihmës ose të tjerëve të cilët japin ndihmën.

Peshkopët të cilët kanë shqetësime se me ndihmën e mirëqenies abuzohet ose mashtrohet, mund t'i telefonojnë linjës së ndihmës për peshkopin (1-801-240-7887) ose zyrës zonale. Kur peshkopi nuk njeh një anëtar, duhet të lidhet me peshkopin e mëparshëm të anëtarit, para se të japë ndihmën e mirëqenies.

PARIMET BAZË TË MIRËQENIES PËR DHËNIE TË NDIHMËS

Peshkopi duhet të udhëhiqet nga parimet bazë të mirëqenies

që vijojnë më poshtë, kur përkujdeset për të varfrit dhe nevojtarët:

- ***Kërko me zell të varfrit.*** Nuk është e mjaftueshme të ndihmohet vetëm kur bëhet kërkesë. Peshkopi duhet të nxisë udhëheqësit e priftërisë e të Shoqatës së Ndihmës, së bashku me mësuesit e shtëpisë dhe mësueset vizitore, që të ndihmojnë për gjetjen e atyre anëtarëve të cilëve u nevojitet ndihmë.
- ***Stimulo përgjegjësinë vetjake.*** Peshkopi shqyrton me anëtarët burimet dhe përpjekjet që ata dhe familjet e tyre mund të sigurojnë në përgjigje të nevojave të tyre.
- ***Ndihmo për jetesë, jo për zakone të jetesës.*** Peshkopi plotëson nevoja bazë të një konsumi jetik. Ai nuk jep ndihmë për të mbajtur një standard të begatë jetese.
- ***Më parë jep artikuj, sesa para.*** Kur është e mundur, peshkopi u siguron anëtarëve artikuj të përdorimit të gjerë, në vend që t'u japë para ose t'u paguajë fatura. Atje ku nuk ka depo të peshkopëve, mund të përdoren ofertat e agjërimit për të blerë artikuj të nevojshëm.
- ***Jep mundësi për të punuar.*** Peshkopët u kërkojnë atyre të cilët marrin ndihmë, të punojnë me aq sa janë në gjendje për atë që marrin. Peshkopët u mësojnë rëndësinë e punës dhe caktojnë punë kuptimplote për të bërë.



*Nën drejtimin e peshkopit këshilli i lagjes
ndihmon që nevojat e mirëqenies të gjejnë zgjidhje.*

Këshilli i lagjes përpilon dhe mban një listë të mundësive për punë që janë domethënëse.

BURIME TË KISHËS TË MUNDSHME PËR TË NDIHMUAR TË VARFRIT

KËSHILLI I LAGJES

Anëtarët e këshillit të lagjes, veçanërisht kuorumet e priftërisë dhe Shoqata e Ndihmës, ndihmojnë peshkopin të plotësojë nevojat e mirëqenies së anëtarëve. Këta udhëheqës ndihmohen nga mësuesit e shtëpisë, mësueset vizitore dhe të tjerë të cilët kanë aftësi të veçanta.

Kur nevojitet, çështje të një natyre të rezervuar mund të diskutohen në mbledhjen e komitetit ekzekutiv të priftërisë, duke

ftuar të marrë pjesë presidencia e Shoqatës së Ndihmës.

KUORUMET E PRIFTËRISË DHE SHOQATA E NDIHMËS

Mirëqenia është pjesë qendrore e rolit të kuorumit të priftërisë dhe të Shoqatës së Ndihmës. Ajo duhet të diskutohet rregullisht në mbledhjet e presidencive. Nën drejtimin e peshkopit kuorumet e priftërisë dhe Shoqata e Ndihmës i ndihmojnë anëtarët të gjejnë zgjidhje për nevoja të mirëqenies dhe për t'u bërë të vetëmbështetur.

PRESIDENTJA E SHOQATËS SË NDIHMËS

Përveç detyrave të saj të mirëqenies të përshkruara në paragrafët paraardhës, presidentja e Shoqatës së Ndihmës zakonisht e ndihmon peshkopin duke



Kur duhet, peshkopi cakton presidenten e Shoqatës së Ndhimës të vizitohet anëtarët për të përcaktuar nevojat e tyre dhe për ta ndihmuar të vendosë ndihmën që mund të jepet.

vizituar anëtarët që u nevojitet ndihma e mirëqenies. Ajo i ndihmon ata të përcaktojnë nevojat e tyre dhe i sugjeron peshkopit ndihmën që mund të jepet. Peshkopi dhe presidentja e Shoqatës së Ndhimës mund të përdorin për ndihmë formularin e Analizës së Nevojave dhe të Burimeve (nr. i artikullit 32290).

SPECIALISTËT E MIRËQENIES TË LAGJES

Këshillat e Peshkopit mund të thirrën një specialist punësimi dhe specialistë të tjerë të mirëqenies. Këta specialistë duhet të jenë anëtarë të lagjes të cilët i ndihmojnë anëtarët e tjerë të lagjes në gjëra të tilla, si: vende pune, arsimim dhe trajnim, ushqyerje dhe higjienë sanitare, Fond i Përhershëm Arsimor, rezervë shtëpiake, kujdes shëndetësor, çështje financiare

të familjes dhe nevoja të tjera të mirëqenies.

OFERTAT E AGJËRIMIT DHE TË DHJETAT

Zoti e ka vendosur ligjin e së dhjetës dhe ligjin e agjërimit, i cili përfshin ofertat e agjërimit, që të bekojë popullin e Tij (shih Isaia 58:6–12; Malakia 3:8–12). Ofertat e agjërimit përdoren vetëm për të plotësuar nevoja të mirëqenies.

Peshkopi, me ndihmën e këshillit të lagjes, u mëson të gjithë anëtarëve rëndësinë e të jetuarit të këtyre ligjeve. Ai gjithashtu u mëson mbi premtimet e Zotit për ata të cilët i jetojnë këto ligje. Këto premtime përfshijnë një ndjesi të qëndrimit më pranë Zotit dhe dhembshuri më të madhe për të tjerët. Zoti gjithashtu premtim rritje të forcës shpirtërore, mbarrëvajtje më të mirë materiale dhe

dëshirë më të fuqishme për të shërbyer.

Në disa zona të botës operojnë depo të peshkopëve për të siguruar ushqim dhe veshje. Aty ku nuk ekziston depoja e peshkopëve, përdoren ofertat e agjërimit për të siguruar ushqim dhe veshje. Ato përdoren gjithashtu për strehim, ndihmë mjekësore dhe ndihmë tjetër të konsumit jetik.

Komiteti i Përgjithshëm i Mirëqenies i Kishës vendos shumën maksimale që një peshkop mund të paguajë pa autorizim shtesë për shpenzimet mjekësore të një anëtari nevojtar. Kur përdoren oferta të agjërimit, kujdesi mjekësor duhet të realizohet tek një institucion mjekësor i përshtatshëm i afërt.

Nuk është kërkesë që shpenzimet e ofertës së agjërimit të mbeten në baraspeshë me kontributet e ofertës së agjërimit.

Ndihma e mirëqenies është për anëtarin e Kishës dhe përgjithësisht financohet me dhurimet e ofertës së agjërimit. Ndihma humanitare e Kishës është për njerëz të të gjitha besimeve dhe përgjithësisht financohet me dhurimet humanitare.

KUNJI DHE BURIME TË TJERA TË KISHËS

Peshkopi mund t'u drejtohet specialistëve të kunjit, qendrave

të punësimit të Kishës, depove të peshkopëve, Deseret Industries dhe Shërbimeve Familjare të SHDM për të ndihmuar anëtarët nevojtarë, kur burime të tilla gjenden.

BURIME JO TË KISHËS TË MUNDSHME PËR TË NDIHMUAR TË VARFRIT

Anëtarët mund të zgjedhin që të përdorin burime të komunitetit, përfshirë burimet qeveritare, për të plotësuar nevojat e tyre bazë. Peshkopi duhet të njihet nga afër me këto burime. Ato mund të përfshijnë:

- Spitale, mjekë ose burime të kujdesit mjekësor.
- Shërbime trajnimi dhe vendi pune.
- Ndihmë për njerëz me aftësi të kufizuara.
- Këshilltarë profesionistë ose punonjës socialë.
- Shërbime për trajtimin e varësive.

Edhe kur anëtarët e Kishës marrin ndihmë nga burime jo të Kishës, peshkopi duhet t'i ndihmojë ata të shmangin rënien në varësi të këtyre burimeve.



Mateu 25:35–36, 40

Kjo broshurë është një përmbledhje e parimeve bazë të mirëqenies dhe e elementeve të vetëmbështetjes, për udhëheqësit e priftërisë dhe të Shoqatës së Ndihmës. Informim i mëtejshëm merret në librin *Providing in the Lord's Way: A Leader's Guide to Welfare*, i cili ofrohet nëpërmjet Shërbimeve të Shpërndarjes të Kishës. Shih edhe providentliving.org.

Kapaku i librit: *Krishti Shëron të Sëmurin në Betesda*, nga Carl Heinrich Bloch, me mirësinë e Muzeut të Artit të Universitetit Brigan Jang
Brenda kapakut të përparmë: *Krishti dhe i Riu i Pasur*, nga Heinrich Hofmann, me mirësinë e C. Harrison Conroy Co., Inc.
Përbri faqes 1: *Qindarkat e së Vesë*, nga Alexandre Bida. Faqja 1: Fotoja – © Robert Casey
Brenda kapakut të pasmë: *Gjithë Qyteti Ishte Mbledhur*, nga James Tissot

© 2009 nga Intellectual Reserve, Inc. Rezervon të gjitha të drejtat. Shtypur në Gjermani. Miratuar për anglisht: 12/08. Miratuar për përkthim: 12/08. Përkthim i *Providing in the Lord's Way: Summary of a Leader's Guide to Welfare*. Albanian. 08257 101
Botuar nga Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, Salt Lake City, Utah

*Q*ëllimi ynë parësor ishte ngritja . . . e një sistemi nën të cilin mallkimi i përtacisë të largohej, të këqijat e lëmoshave të zhdukeshin dhe pavarësia, puna sistematike, kursimi dhe vetërespekti të vendosen rishitas mes njerëzve tanë. Objektivi i Kishës është të ndihmohen njerëzit që të ndihmojnë vetveten. Puna duhet të kurorëzohet sërish si parimi sundues i jetës së anëtarësisë së Kishës sonë.

Presidencia e Parë, në Raportin e Konferencës, tetor 1936, f. 3.

KISHA E
JEZU KRISHTIT
E SHENJTORËVE TË
DITËVE TË MËVONSHME

